

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMPANIA REGJIONALE E UJITJES RADONIQI-DUKAGJINI SH.A**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KRU-26-5880-2-1-3**

Sa i përket tenderit për **Hartimi i projektit dhe Dizajnin Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqit-Dukagjini për zonën e Rahovecit, Suharekës, Mamushë dhe Prizren.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	KIWER SH.P.K.
NUI	810805757
Adresa	Shaqir Igrishta, Mati 1, A11, Hy-08, Nr.34,
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044 159 456
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ramiz Kokollari
Adresa elektronike	ramiz.kokollari@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	09.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Hartimi i projektit dhe Dizajnin Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqit-Dukagjini per zonen e Rahovecit,Suharekes,Mamushë dhe Prizren.

Në bazë të aktivitetit të prokurimit me titull "Hartimi i projektit dhe Dizajnin Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqit-Dukagjini per zonen e Rahovecit,Suharekes,Mamushë dhe Prizren", me nr. të prokurimit KRU-26-5880-2-1-3, në afatin e rregullt kohor paraqesim këtë Kërkesë për Rishqyrtim:

- **20.07.2026 – Publikimi i Njoftimit për Kontratë;**
- **03.08.2026 – Paraqitja e Kërkesës për Rishqyrtim.**
- **06.08.2026 – Refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues.**
- **09.08.2026 – Paraqitja e Ankesës te Organi Shqyrtues i Prokurimit**
- **10.08.2026 – Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projektit dhe Dizajnit Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqit-Dukagjini për zonën e Rahovecit, Suharekës, Mamushës dhe Prizrenit” kemi dorëzuar brenda afateve ligjore Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues KOMPANIA REGIONALE E UJITJES RADONIQI-DUKAGJINI SH.A lidhur me Njoftimin për Kontratë dhe pretendimet tona për mosrespektimin e dispozitave ligjore.

Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të pabazuar. Ne nuk pajtohemi me këtë vendim dhe për këtë arsye i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK, me rastin e zhvillimit të aktivitetit të prokurimit me titull “Hartimi i Projektit dhe Dizajnit Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqit-Dukagjini për zonën e Rahovecit, Suharekës, Mamushës dhe Prizrenit”, me nr. të prokurimit KRU-26-5880-2-1-3, nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, respektivisht:

- Neni 1 – Qëllimi;
- Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi;
- Neni 20 – Klasifikimi i Konkursit të Projektimit sipas Vlerës;
- Neni 27 – Dosja e Tenderit;
- Neni 44 – Rregullat e Përgjithshme mbi Caktimin e Afateve Kohore për Pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje;
- Neni 46 – Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimeve të afateve kohore;
- Neni 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes;
- Neni 52 – Njoftimi i Kritereve për Dhënien e Kontratës;
- Neni 55 – Mënyrat e Komunikimit;
- Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
- Neni 73 – Dispozitat e Përgjithshme për Konkursin e Projektimit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkëlqjen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI 1.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Projektit dhe Dizajnit Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqi-Dukagjini për zonën e Rahovecit, Suharekës, Mamushës dhe Prizrenit”, me vlerë të parashikuar prej 400,000.00 €.

Bazuar në nenin 20, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, ky aktivitet klasifikohet si konkurs projektimi me vlerë të madhe, pasi vlera e parashikuar tejkalon pragun prej 125,000.00 €. Për këtë kategori, neni 44, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i të njëjtit ligj përcakton se afati për pranimin e tenderëve nuk mund të jetë më i shkurtër se 40 ditë.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka caktuar si afat të fundit për pranimin e ofertave datën 10.08.2026, ndërsa njoftimi për kontratë është publikuar më 20.07.2026. Si rezultat, operatorët ekonomikë kanë pasur në dispozicion vetëm 21 ditë kalendarike për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave, afat i llogaritur nga data e publikimit të njoftimit për kontratë deri në datën e fundit të caktuar për pranimin e ofertave.

Duke pasur parasysh natyrën dhe kompleksitetin e kësaj kontrate, e cila përfshin përgatitjen e studimit të fizibilitetit, projektit dhe dizajnit teknik, si dhe nevojën për angazhimin dhe koordinimin e një ekipi multidisiplinar ekspertësh, vlerësojmë se ky afat nuk është i mjaftueshëm për përgatitjen e një oferte cilësore dhe konkurruese.

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën tonë, duke arsyetuar shkurtimin e afatit me faktin se aktiviteti është prioritar dhe se afati i përcaktuar është i mjaftueshëm.

Nuk pajtohem me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues se shkurtimi i afatit për dorëzimin e ofertave është i arsyeshëm për shkak të prioritetit të aktivitetit. Konsiderojmë se përcaktimi i aktivitetit si prioritar nuk përbën në vetvete bazë ligjore për përdorimin e afateve të përshpejtuara. Neni 46 i LPP-së lejon shkurtimin e afateve vetëm në raste urgjente, kur respektimi i afateve të rregullta është i pamundur dhe kur rrethanat që kanë krijuar urgjencën nuk mund t’u atribuohen veprimeve apo mosveprimeve të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast, AK nuk ka paraqitur asnjë rrethanë konkrete që do të arsyetonte ekzistimin e një urgjence të tillë.

Për më tepër, kjo procedurë është duke u prokuruar për herë të parë dhe nuk paraqet ritenderim, prandaj nevoja për realizimin e saj brenda një periudhe të caktuar nuk mund të arsyetohet përmes shkurtimit të afatit si rezultat i planifikimit jo me kohë të aktivitetit.

Gjithashtu, nuk qëndron arsyetimi se afati i përcaktuar është i mjaftueshëm, pasi Dosja e Konkursit kërkon që operatorët ekonomikë, krahas Dokumentacionit të Kandidatit, të përgatisin dhe dorëzojnë edhe Konceptin e Projektit, i cili i nënshtrohet vlerësimit nga juria, ndërsa oferta teknike ka peshë prej 80% në vlerësim. Duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, një afat kaq i shkurtër nuk ofron kohë të arsyeshme për përgatitjen e një propozimi cilësor dhe konkurrues dhe kufizon konkurrencën e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye, konsiderojmë se caktimi i këtij afati është në kundërshtim me nenin 44 dhe nenin 46 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe me nenin 20.1 të Rregullores për Prokurimin Publik, ndërsa njëkohësisht cenon parimet e barazisë në trajtim dhe konkurrencës të përcaktuara me nenin 7 të LPP-së.

PRETENDIMI 2.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar vetëm kriteret minimale të kapacitetit teknik dhe profesional që operatorët ekonomikë dhe stafi profesional duhet t’i plotësojnë për t’u kualifikuar në procedurë. Për operatorin ekonomik kërkohet përvojë në realizimin e kontratave për shërbime konsulente në sektorin e ujërave, që përfshijnë studime të fizibilitetit, master plane, analiza hidrologjike, analiza dhe modelime hidraulike, projekte të sistemeve të ujitjes, projekte në fushën e ujit ose fusha të ngjashme, në një vlerë minimale prej 600,000.00 €. Si rrjedhojë, operatori ekonomik mund ta plotësojë këtë kriter edhe pa dëshmuar përvojë të drejtpërdrejtë në projektimin e sistemeve të ujitjes. Po ashtu, për shumicën e ekspertëve

kërkohet vetëm përvojë e përgjithshme profesionale ose përvojë në fushën përkatëse, pa u kërkuar përvojë specifike në projekte të sistemeve të ujitjes ose projekte të ngjashme me objektin e kontratës.

Për më tepër, pas përmbushjes së këtyre kriterëve minimale, Dosja e Tenderit nuk parasheh asnjë kriter vlerësimi për përvojën relevante të operatorit ekonomik dhe stafit profesional në projektimin e sistemeve të ujitjes. Pra, përvoja specifike në këtë fushë as nuk kërkohet si kusht i domosdoshëm për OE-në dhe shumicën e ekspertëve, as nuk vlerësohet në fazën e dhënies së kontratës. Si rezultat, operatorët ekonomikë dhe ekspertët me përvojë të specializuar në këtë fushë trajtohen njësoj me ata që plotësojnë kriteret përmes përvojave në fusha të tjera, edhe kur ato nuk janë drejtpërdrejt relevante me objektin e kontratës.

Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, nenin 7, nenin 52 dhe nenin 73 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, pasi kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit nuk mundësojnë dallimin ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe ekspertëve me përvojë specifike në projektimin e sistemeve të ujitjes dhe atyre që plotësojnë vetëm kriteret minimale, duke mos siguruar përzgjedhjen e zgjidhjes projektuese me cilësinë më të mirë.

PRETENDIMI 5.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka kërkuar që ekspertët e profileve të caktuara të posedojnë Licencën A, pa paraparë mundësinë e pranimi të licencave ekuivalente (të barasvlefshme) të lëshuara nga autoritetet kompetente të shteteve të tjera.

Duke qenë se Licenca A lëshohet vetëm nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës, kjo kërkesë vendos në pozitë të pabarabartë operatorët ekonomikë të huaj dhe kufizon konkurrencën, pasi ekspertët e tyre, edhe pse mund të posedojnë licenca profesionale ekuivalente (të barasvlefshme), nuk mund ta plotësojnë këtë kërkesë në formën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i cili garanton trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar atë si të pabazuar, ndërsa njëkohësisht në arsyetimin e vendimit ka deklaruar se do të pranohen edhe licencat ekuivalente.

Kjo përgjigje është kontradiktore dhe nuk e korrigjon çështjen e ngritur në kërkesën tonë për rishqyrtim. Nëse AK konsideron se licencat ekuivalente janë të pranueshme, kjo duhet të reflektohet shprehimisht në Dosjen e Konkursit. Megjithatë, AK e ka refuzuar pretendimin dhe nuk e ka ndryshuar Dosjen, ku vazhdon të figurojë vetëm kërkesa për Licencën A, pa formulimin “ose ekuivalente (e barasvlefshme)”.

Kjo krijon mospërpjethje ndërmjet kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Konkursit dhe interpretimit të dhënë nga AK në vendimin për rishqyrtim dhe lë hapësirë për interpretim gjatë vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, mbesim pranë Pretendimit 5 dhe konsiderojmë se Dosja e Konkursit duhet të përcaktojë shprehimisht “Licenca A ose ekuivalente (e barasvlefshme)”, në mënyrë që kriteri të jetë i qartë dhe të zbatohet njësoj ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

PRETENDIMI 6.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka kërkuar që Eksperti i Mjedisit të posedojë diplomë universitare në Inxhinieri të Mjedisit dhe të jetë ekspert i licencuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM).

Kjo kërkesë kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën, pasi numri i inxhinierëve të mjedisit që njëkohësisht posedojnë licencë për VNM në Republikën e Kosovës është shumë i kufizuar. Për më tepër, legjislacioni që rregullon licencimin e ekspertëve për VNM nuk e kufizon pajisjen me këtë licencë vetëm për personat me diplomë në Inxhinieri të Mjedisit, ndërsa Dosja e Tenderit përjashton profile të tjera universitare relevante që mund të jenë të licencuara për VNM.

VNM është një proces multidisiplinar dhe përfshin, përveç aspekteve të përgjithshme mjedisore, edhe biodiversitetin, aspektet sociale, ligjore, planifikimin hapësinor dhe fusha të tjera relevante. Për rrjedhojë, një profil i vetëm universitar nuk ka ekskluzivitet profesional mbi VNM, ndërsa kriteri i vendosur nga AK e ngushton në mënyrë të konsiderueshme rrethin e ekspertëve të disponueshëm dhe, rrjedhimisht, edhe të

operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë.

Për këtë arsye, kemi kërkuar që të largohet kërkesa për diplomë universitare vetëm në Inxhinieri të Mjedisit dhe të lejohet edhe angazhimi i profileve të tjera universitare relevante që posedojnë licencë për VNM. Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, pasi ka vendosur një kërkesë që kufizon konkurrencën pa një arsyetim objektiv. Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar atë dhe, në vend që t'i përgjigjet çështjes konkrete të ngritur, është referuar në përgjigjen e dhënë për Pretendimin 5, duke deklaruar se pranohen kërkesat/licencat ekuivalente.

Konsiderojmë se AK i është shmangur përgjigjes ndaj çështjes konkrete të ngritur në kërkesën tonë për rishqyrtim dhe, përmes kësaj shmangieje, e ka lënë kërkesën e Dosjes së Konkursit të pandryshuar.

Pretendimi ynë nuk ka qenë që të pranohet një diplomë ekuivalente me Inxhinierinë e Mjedisit, por që të pranohen edhe profile të tjera universitare relevante që posedojnë licencë për VNM.

Një kualifikim ekuivalent (i barasvlefshëm) me Inxhinierinë e Mjedisit nënkupton një kualifikim të barasvlefshëm me profilin e kërkuar dhe nuk është e njëjta gjë me pranimin e profileve të tjera relevante profesionale. Prandaj, referimi i AK-së të "ekuivalenca" nuk e adreson pretendimin tonë dhe nuk jep asnjë arsyetim se përse kjo pozitë duhet të kufizohet ekskluzivisht në Inxhinieri të Mjedisit.

Shmangia e adresimit të çështjes konkrete dhe refuzimi i pretendimit pa dhënë arsyetim mbi substancën e tij përbën shkelje të detyrimit të AK-së për shqyrtimin dhe arsyetimin e pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim. Për këtë arsye, mbesim pranë Pretendimit 6 dhe konsiderojmë se kufizimi vetëm në profilin e Inxhinierisë së Mjedisit cenon konkurrencën dhe është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

PRETENDIMI 7.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka kërkuar që përvoja profesionale e ekspertëve të dëshmohet me CV.

CV-ja, për nga natyra e saj, paraqet vetëm një deklaram të përvojës profesionale dhe nuk përbën dokument objektiv për vërtetimin e saj. Përvoja profesionale duhet të mbështetet me dokumente të verifikueshme, si referenca, kontrata ose vërtetime nga autoritetet kontraktuese apo klientët, të cilat dëshmojnë angazhimet e realizuara.

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues jo vetëm që nuk e ka adresuar pretendimin tonë, por edhe e ka keqinterpretuar përmbajtjen e tij. Në kërkesën për rishqyrtim kemi theksuar qartë se CV-ja e vetme nuk përbën dëshmi objektive të përvojës profesionale, pasi ajo përgatitet nga vetë eksperti dhe përmban deklaramet e tij.

Pretendimi ynë nuk është se CV-ja nuk mund të përdoret si dokument, por se përvoja e deklaruar në CV duhet të mbështetet me dëshmi përkatëse që mundësojnë verifikimin objektiv të saj; në të kundërtën, krijohet mundësia që në CV të deklarohen edhe të dhëna të pasakta apo të pavërteta.

Për këtë arsye, mbesim pranë Pretendimit 7 dhe konsiderojmë se përgjigjja e AK-së nuk e adreson çështjen konkrete të ngritur në kërkesën tonë për rishqyrtim.

PRETENDIMI 8.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Konkursit, ka paraparë përgatitjen e Studimit të Fizibilitetit, hartimin e projektit dhe dizajnit teknik për rehabilitimin e kanalit kryesor ekzistues, strukturave përcjellëse dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes, ndërsa Dosja nuk përmban informata të mjaftueshme teknike mbi infrastrukturën ekzistuese që duhet të verifikohet dhe projektohet.

Në veçanti, mungojnë informata të mjaftueshme lidhur me gjendjen e infrastrukturës ekzistuese, objektet dhe strukturat që përfshihen në projektim dhe dokumentacionin teknik ekzistues. Kjo krijon pasiguri të konsiderueshme për operatorët ekonomikë në vlerësimin e shtrirjes së shërbimeve, nivelit të angazhimit profesional, resurseve dhe kostos së nevojshme për realizimin e kontratës.

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë, duke arsyetuar se informatat dhe sqarimet përkatëse janë dhënë gjatë Site Visit.

Nuk pajtohemi me përgjigjen e Autoritetit Kontraktues dhe mbesim pranë pretendimit të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim, se Dosja e Konkursit nuk përmban informata të mjaftueshme teknike mbi

infrastrukturën ekzistuese, gjendjen e saj dhe strukturat që janë objekt i projektimit.

Arsyetimi i AK-së se informatat dhe sqarimet janë dhënë gjatë Site Visit nuk mund të merret si i mirëqenë, pasi ne nuk posedojmë ndonjë dokumentacion që dëshmon se këto informata janë formalizuar dhe janë vënë në dispozicion të të gjithë operatorëve ekonomikë.

Neni 55.2 i LPP-së përcakton se, kur gjatë vend-shikimit bëhen komunikime gojore, AK duhet menjëherë të përgatisë përmbledhjen e të gjitha aspekteve materiale të komunikimit dhe ta bëjë atë të disponueshme për të gjithë operatorët e interesuar.

Prandaj, nëse AK mbështetet në Site Visit për të argumentuar se informacionet e nevojshme janë dhënë, duhet të ekzistojë dokumentacioni përkatës që dëshmon se informacionet materiale të komunikuar janë formalizuar dhe janë vënë në dispozicion të të gjithë operatorëve ekonomikë. Në mungesë të një dokumenti të tillë, komunikimet gojore gjatë Site Visit nuk mund të përdoren për të plotësuar mangësitë e Dosjes së Konkursit, pasi kjo cenon qasjen e barabartë në informacion.

Për këto arsye, mbesim pranë Pretendimit 8 dhe konsiderojmë se përgjigjja e AK-së nuk e eliminon mangësinë e ngritur në kërkesën për rishqyrtim.

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë dhe nuk ka pranuar nevojën për ndryshimin e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësimit.

Nuk pajtohem me përgjigjen e Autoritetit Kontraktues dhe mbesim pranë pretendimit të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim. Siç kemi theksuar, Aneksi 5 vlerëson konceptin teknik dhe metodologjinë, ndërsa nuk vlerëson përvojën relevante të operatorit ekonomik dhe stafit profesional, edhe pse bëhet fjalë për një kontratë komplekse për studim fizibiliteti dhe projektim të sistemit të ujitjes. Përvoja specifike në këtë lëmi nuk kërkohet as si kriter minimal për OE-në, ndërsa për shumicën e ekspertëve nuk kërkohet përvojë në projekte të ngjashme.

Konsiderojmë veçanërisht kontradiktor faktin që AK, në përgjigjen ndaj Pretendimit 3, arsyeton vendosjen e kërkesave shtesë pikërisht me kompleksitetin e aktivitetit, ndërsa të njëjtin kompleksitet nuk e ka reflektuar në kriteret që do të mundësonin vlerësimin e përvojës dhe kompetencës reale të OE-së dhe ekipit profesional.

Një përcaktim i tillë vendos në pozitë të njëjtë operatorët me përvojë të dëshmuar dhe operatorët pa përvojë relevante, duke krijuar dyshim të arsyeshëm për favorizim dhe duke rrezikuar përzgjedhjen e një operatori jokompetent për realizimin e një projekti të kësaj rëndësie.

Për këto arsye, mbesim pranë pretendimit dhe bazës ligjore të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim, përkatësisht se kriteret e përcaktuara nuk sigurojnë përzgjedhjen reale të Tenderit Ekonomikisht Më të Favorshëm dhe janë në kundërshtim me nenin 1, nenin 7, nenin 52 dhe nenin 73 të LPP-së.

PRETENDIMI 3

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka kërkuar që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001, ndërsa në rast të ofertimit si grup i operatorëve ekonomikë ka përcaktuar se secili anëtar i grupit duhet t'i posedojë këto certifikata.

Kjo kërkesë është joproporcionale me objektin e kontratës dhe kufizon në mënyrë të pajustificuar konkurrencën, pasi obligon secilin anëtar të grupit të operatorëve ekonomikë të posedojë të gjitha certifikatat ISO, pavarësisht rolit dhe pjesëmarrjes së tij në realizimin e kontratës. Në rastin e ofertave të përbashkëta, nëse konsorciumi i posedon certifikatat e kërkuara, sigurohet që detyrat do të zbatohen sipas sistemeve përkatëse. Kërkesa që secili anëtar individualisht të posedojë të njëjtat certifikata nuk krijon vlerë apo garanci shtesë për realizimin e kontratës, ndërsa kufizon konkurrencën dhe mundësinë e formimit të konsorciumeve.

Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 51 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë, duke e arsyetuar kërkesën me kompleksitetin e aktivitetit.

Nuk pajtohem me këtë arsyetim. Kompleksiteti i aktivitetit nuk shpjegon se çfarë vlere apo garancie konkrete shtesë sigurohet duke kërkuar që secili anëtar i konsorciumit t'i posedojë individualisht të tri certifikatat ISO. Nëse grupi i operatorëve ekonomikë i posedon certifikatat dhe organizon realizimin e kontratës në përputhje me to, qëllimi i kërkesës është përmbushur.

Arsyetimi i AK-së është edhe më kontradiktor kur në të njëjtën Dosje kriteret e tjera janë përcaktuar në

mënyrë që lejojnë pjesëmarrjen e OE-ve pa përvojë specifike në këtë lëmi dhe të stafit pa përvojë relevante në projekte të ngjashme.

Për këto arsye, mbesim pranë Pretendimit 3 dhe konsiderojmë se kjo kërkesë është e panevojshme, joproporcionale, kufizon konkurrencën dhe është në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 51 të LPP-së.

PRETENDIMI 4.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, nuk ka përcaktuar fare afatin për realizimin e kontratës, duke mos u ofruar operatorëve ekonomikë një nga elementet thelbësore për përgatitjen e ofertës, vlerësimin e kostove dhe planifikimin e angazhimit të burimeve të nevojshme për realizimin e kontratës.

Sipas nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, dosja e tenderit duhet të përmbajë të gjitha informatat relevante për kontratën përkatëse, përfshirë të gjitha kushtet materiale të kontratës dhe informacionet e nevojshme që u mundësojnë operatorëve ekonomikë përgatitjen e ofertave në mënyrë të duhur.

Duke mos përcaktuar afatin për realizimin e kontratës, Autoriteti Kontraktues ka hartuar një Dosje të Tenderit që nuk përmban një nga kushtet materiale të kontratës, në kundërshtim me nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Mungesa e këtij informacioni cenon transparencën e procedurës dhe pamundëson që operatorët ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në kushte të barabarta, në kundërshtim edhe me nenin 7 të po këtij ligji.

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë me arsyetimin se në këtë fazë dorëzohet vetëm projekti ideor dhe se kontrata do të nënshkruhet në fazën pasuese, duke iu referuar Nenit 55 të Rregullores.

Nuk pajtohem me këtë arsyetim. Neni 55 nuk përcakton se afati i realizimit të kontratës mund të lihet i papërcaktuar në Dosjen e Konkursit. Përkundrazi, në rastin kur konkursi shpie në dhënien e kontratës për projektimin e detajuar, Rregullorja parasheh që OE-të që në këtë fazë të dorëzojnë edhe ofertën financiare për projektimin e detajuar.

Pa e ditur kohëzgjatjen e kontratës, OE-të nuk mund të vlerësojnë në mënyrë të saktë angazhimin e stafit, planifikimin e aktiviteteve dhe kostot e realizimit.

Për këtë arsye, mbesim pranë pretendimit se mospërcaktimi i afatit është në kundërshtim me nenin 27 dhe nenin 7 të LPP-së, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik që kërkojnë përcaktimin e kohëzgjatjes dhe orarit të angazhimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e pretenduara na shkaktojnë dëm të drejtpërdrejtë ekonomik pasi kufizojnë mundësinë tonë për të konkurruar në mënyrë të barabartë në një aktivitet prokurimi që lidhet drejtpërdrejt me fushën kryesore të veprimtarisë dhe ekspertizës së kompanisë sonë.

Kjo na cenon mundësinë reale për të fituar dhe realizuar kontratën me vlerë të parashikuar prej 400,000.00 €, krahas kostove dhe resurseve të angazhuara për pjesëmarrje në këtë procedurë dhe mbrojtjen e interesit tonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.